



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje lëndë e parë dhe materiale ndihmëse në funksion të realizimit të veprave të artit” për nevoja të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit “Tirana”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44423000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,332,200 (tetë milion e treqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë në cilësinë e organit të deleguar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në mbeshtetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) në nenin 83 të LPP citohet si vijon: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, gjithashtu në nenin 83 të LPP citohet si vijon: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas*



parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2022,2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

2.2.2 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit që prokurohet nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:



... 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;”.
Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtet vendor për shlyerjen e taksave vendore (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

****Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

231 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,



afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40/4, dhe nenit 55 pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55 si më sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalente/të barazvlefshme – Standart për “Sistemin e menaxhimit të Cilësisë” (e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

Argumentimi: *Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), ku citohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësie”, si në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), konkretisht: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

Standarti ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij,



kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e Autoritetit kontraktor të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si çertifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, në ditën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, me adresë: Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", Tiranë duhet të paraqesë të paketuara dhe të protokolluara mostra për disa nga artikujt objekt prokurimi si më poshtë vijon:

1. Bronz 2. Qymyr koks 3. Tel bronzi per saldim 4. Parafine 5. Shamot 6. Patine Bronzi 7. Shamot 8. Tel inox per saldim 9. Gome

Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e kontrollit të mostrave të sjella me përputhshmerinë e specifikimeve të kërkuara. Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedurës.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet



e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Janë kërkuar mostra pikërisht për këto zëra duke qënë se janë elemente tepër të rëndësishëm dhe thelbësorë në mbarëvajtjen, qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e veprës që do të duhet të realizohet.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Specifikime teknike: “Blerje lëndë e parë dhe materiale ndihmëse në funksion të realizimit të veprave të artit” për nevoja të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit ”Tirana”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Detyrë kryesore funksionale e Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit është realizimi i veprave monumentale në skulpturë, plastikë të parkut, zbukurime, dekoracione me rëndësi për trashëgiminë dhe zbukurimin e qytetit të Tiranës. **Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit "Tirana" kryen mirëmbajtjen, pastrimin dhe restaurimin e veprave ekzistuese në territorin e Bashkisë Tiranë, si dhe çdo funksion tjetër të përcaktuar në rregulloren e saj të organizimit dhe funksionimit. Specifikimet teknike lidhur me artikujt e kwrkuar janë hartuar si të tilla referuar nevojave të Autoritetit Kontraktor pwrfitues QRRVAT i cili merret me punime të vecanta, punime artizanale dhe kerkesave funksionale te tij per mallrat objekt prokurimi. Specifikimet teknike per llojin e materialit i referohen standarteve ne fuqi dhe janë si më poshtë vijon:**

- Bronz:** materiali të përbëhet nga 85% bakër, 5 % kallaj, 3.5 % plumb dhe 1.5% cilic.
- Qymyr koks:** materiali të jetë lëndë djegëse, ngjyrë gri e errët, material i fortë dhe poroze me bazë qymyri me përmbajtje të lartë karboni. Qymyri do përdoret për shkrirjen e mineralit të hekurit, por edhe si lëndë djegëse në soba dhe farkë. Përbërësit e koksit të jenë katrani i qymyrit, amoniaku (NH₃), sulfidi i hidrogjenit (H₂S), piridina, cianidi i hidrogjenit dhe materiali me bazë karboni. **Vetitë mekanike të metalit të saldimit**
- Llmarine Bronzi 200x100cm spensor 2mm,** materiali të jetë cilësorë, spensori i trashësisë të jetë 2mm, materiali do përdoret kryesisht për riparime të veprave të artit dhe në tabelat me emërtime.
- Tel bronzi për saldim 1.5mm,** materiali të jetë shumë cilësor, teli do përdoret për saldimin e punimeve në veprat e artit. Cdo bobinë duhet të ketë vetitë e paraqitura në skedën teknike: për saldim ka këto specifikime:

Vetitë mekanike të metalit të saldimit

Forca e rendimenti t Rp0,2 MPa	Rezistenca në tërheqje Rm MPa	Zgjatimi A5 %	Ngurtësia HB	Përçueshmëria e El. S — m mm ²	Diapazoni i shkrirjes ° C
150	300	20	80	7 - 9	910 - 1040

Analiza e metaleve të saldimit %

Sn	P	Cu	Fe
7.0	< 0,3	balance	< 0,1

- Dyll :** Materiali të jetë cilësorë, ngjyra e dyllit të jetë e verdhë, materiali do përdoret për realizimin e skulpturave përpara se të realizohen në bronz, përzihet me parafinën për të shtuar ose rritur fortësinë.
- Parafinë:** Materiali të jetë cilësorë, ngjyrë e tij të jetë e bardhë, ajo përzihet me bronzin dhe ndërveprimi i tyre shton apo rrit fortësinë e veprës.



- 7. Gaz argon:** për saldimin e bronzit (bombula aktualisht 40 l dhe 47.8 l). Për shkak të vetive të tij si gaz që nuk lidhet me gaze të tjerë, argoni është gazi ideal mbrojtës për saldim, madje edhe në temperaturë shumë të larta të harkut plazmatik, gjë që ndodh shpesh në përpunimin e metaleve. Në të vërtetë edhe në temperatura shumë të larta dhe në dallim nga azoti, argoni mbetet inert dhe nuk formon përzierje me oksigjenin.
- 8. Shamot:** Materiali të jetë cilësor, pluhur tulle, zjarrëduruese, përdoret për kopjim të skulpturës në teknikën e dyllit, piqet në temperaturë 800 °C, është prodhim artizanal dhe jo prodhim industrial.
- 9. Allçi Skulpture:** Materiali të jetë cilësorë, në çdo paketim të paraqitet skeda teknike me të dhënat e mëposhtme:
Për Miksimin me ujën në raportin 1;5, Paketimi: 50 kg, Koha e tharjes: Me pjekje: 1.5 orë; të rilyej; 2.5 orë; përfundimtar: 20-24 orë, Mbulimi: 1,0-1,5 kg/m², Marka: BE
Allçia dekoruese kohën e ngrirjes duhet ta ketë 25 min deri në 30 min. Ekzistojne dy variante për përdorimin e allçisë që janë:
1) Pas realizimit të veprës në argjil (baltë) ajo kthehet dhe kopjohet në allçi dhe në këtë rast funksioni i allçisë është për të kopjuar veprën.
2) Në rastin e dytë për realizimin e veprës përdoret direkt allçia për modelimin e veprës pra në këtë rast funksioni i allçisë është ai i modelimit. Pas realizimit të veprave në allçi bëhet prerja e objektit që më pas t'i nënshtrohet realizimit të procesit të bronzit dhe mbas realizimit me bronz ato bashkohen sërish saldohen dhe më pas tonohen me patinën e bronzit. Allçia kërkohet me këto specifikime për arsye që veshja e busteve të dalë sa më e plotë.
- 10. Acid Klorhidrik:** Materiali të jetë cilësorë, në çdo paketim të paraqitet skeda teknike me të dhënat e mëposhtme. Përdorimi: Profesional, Aroma: Jo, Kapaciteti: 1000 ml, Ngjyra: Jeshile, Paketimi: 1 liter, Marka: BE
- 11. Patinë Bronzi:** Materiali të jetë cilësorë, Patina është një solucion i cili shkakton një reaksion kimik për tonimin e bronzit dhe kërkohet të ofrohet në katër forma sikundër janë: për secilën formë do jetë sasia 50 litra
a. Brown S (kafe e errët)
b. Brown K (kanell pak e celët)
c. Green I ose J (jeshile antike)
d. Black C (e zezë)
- 12. Llamarinë Inox:** Llamarina të jetë materiali celik inoksi, Kualiteti dhe standarti CE i Inox-it të jetë konform AISI 304- 304L321- 316L- 316TI – 430- 309 -310 Llamarinë Inox-it do jetë me përmasat 2000x1000 mm. Spesori i Inox-it të jetë 2mm, Kualitetit dhe standartit CE AISI 304- 316 -316L.
- 13. Tel inox për saldim 1.5mm:** Materiali të jetë cilësorë dhe kualiteti i lartë, teli celik inox të jetë në spensor 1.5mm, Teli celik inox do përdoret për Saldim MIG, të paraqitet në bobinë 25kg, Teli celik



inxot do përdoret për Saldim pa gaz, në rrotull ER308I i përshtatshëm për veglat të serisë së saldimeve MIG.

14. Profile hekuri 20x20 spesor 4mm: Profilet metalike janë ndër ato produkte bazë, që përdoren në struktura të ndryshme ndërtimi, në ambiente të jashtme dhe të brendshme. Prodhimi dhe cilësia e tyre të jetë me standarte dhe çertifikatë cilësie, mjaft rezistentë ndaj korrozionit pas lyerjes me bojë plastike. dimensione dhe spesorë sipas kërkesës, për t'u montuar me bullona ose me saldim. Gjatesia 6m, Masa 20x20 mm, Materiali: Hekur Celik, Spesori 4mm.

15. Profile hekuri 30x30 spesor 4mm: Profilet metalike janë ndër ato produkte bazë, që përdoren në struktura të ndryshme ndërtimi, në ambiente të jashtme dhe të brendshme. Prodhimi dhe cilësia e tyre të jetë me standarte dhe çertifikatë cilësie, mjaft rezistentë ndaj korrozionit pas lyerjes me bojë plastike. dimensione dhe spesorë sipas kërkesës, për tu montuar me bullona ose me saldim. Gjatesia 6m, Masa 30x30 mm, Materiali: Hekur Celik, Spesori 4mm.

16. Profile hekuri 40x40 spesor 4mm: Profilet metalike janë ndër ato produkte bazë, që përdoren në struktura të ndryshme ndërtimi, në ambiente të jashtme dhe të brendshme. Prodhimi dhe cilësia e tyre të jetë me standarte dhe çertifikatë cilësie, mjaft rezistentë ndaj korrozionit pas lyerjes me bojë plastike. dimensione dhe spesorë sipas kërkesës, për t'u montuar me bullona ose me saldim. Gjatesia 6m, Masa 40x40 mm, Materiali: Hekur Celik, Spesori 4mm.

17. Llamarine hekuri 200x100cm spesor 2mm: Llamarina të jetë materiali hekur celik, Kualiteti dhe standarti, Llamarinë të jetë e kordinuar për mos rrëshqitjen, po ashtu edhe për efekt dekorativ sipas kërkesave të specialistëve. Ngjyre e zezë Decape, Spesorë 2 mm, përmasat 200x100cm, Materiali hekur Celik.

18. Tel saldimi hekuri 1.5mm: Materiali të jetë cilësor dhe kualiteti i lartë, teli celik hekur të jetë në spesor 1.5 mm, Tel Argoni do përdoret për saldimin e natyrave të ndryshme të çelikut dhe me standarte të ndryshme operimi, në varësi të pastërtisë së metalit, sforcimit të aplikuar, këndit të operimit apo spesorit që do të saldohet. Tel Argoni, të jetë me spesor 1.5 mm, Bobine 25 kg, ky material të jetë i dizenuar për aparate saldimi automatikë që përdoret për konstruksionet metalike dhe saldimet voluminoze.

19. Gomë: Materiali të jetë cilësorë dhe me kualitetet të lartë, materiali do përdoret në teknikë në kopjim të skulptures dhe është në trajtë xheli + katalit.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar).

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar të njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje lëndë e parë dhe materiale ndihmëse në funksion të realizimit të veprave të artit” për nevoja të Qendrës së Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit “Tirana”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

Dokumentat e tenderit
Specifikimet teknike

NJËSIA E PROKURIMIT